

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E XI-TË E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË,
MBAJTUR MË 27 NËNTOR 2014

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën **10:07**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Agim Bregaj, Agron Perquku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Syzana Sylja, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – për në të “ndryshme” propozoi këto pika të rendit të ditës:

- a. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndarje të mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione;
- b. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për formimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se edhe në mbledhjet paraprake të kuvendit është ngritur shqetësimi lidhur me vendosjen e orëve të rrymës elektrike nëpër shtyllat e rrymës elektrike, prandaj pyeti se a ka pëlqim nga organet komunale për këtë çështje, pasi që ato janë asete të komunës, sa paguhet qiraja për to, si dhe a paraqesin rrezik telat e zhveshur për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, prandaj kërkoi informatë për mbledhjen e ardhshme të KK-së lidhur me këtë problematikë.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me vota unanime miratoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mirëqenien sociale, strehimin familjar dhe përkujdesjen për të moshuarit.
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve.
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e ambientit.
5. Shqyrtimi i Propozimit për konfirmim të investimeve kapitale me bashkëfinancim për vitet 2015 dhe 2016.
6. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për formimin e komisionit për çështje banesore.
8. Të ndryshme:
 - a. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndarje të mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione;
 - b. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për formimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale;
 - c. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Aprovohet me vota unanime procesverbali në fjalë, pa vërejtje dhe sugjerime.

2. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mirëqenien sociale, strehimin familjar dhe përkujdesjen për të moshuarit.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - tha se informata në fjalë është dashtë të mos e ketë edhe fjalinë “mirëqenie soaciale”, pasi që në “mirëqenie sociale” hyjnë shumë kategori, sepse në këtë informatë flitet vetëm për strehimin familjar dhe përkujdesjen sociale, edhe pse në këtë informatë është dashtë të përfshihen të gjitha kategoritë. Pastaj tha se në mbledhjen e KPF-së është kërkuar që të specifikohet numri i anëtarëve të familjes së Gani Bunjakut. Po ashtu tha se në këtë informatë është dashtë të përmendet numri i familjeve që kanë nevojë dhe që kanë probleme me strehim në Komunën e Vushtrrisë. Në vazhdim në emër të Grupit kuvendar të LDK-së propozoi që Komuna e Vushtrrisë të sigurojë një objekt për të moshuarit për qëndrim ditor, për t’iu ofruar përkujdesi shëndetësor dhe disa gjëra higjienike, dhe përmendi objektin tek banimi social i ndërtuar nga shoqata “Gratë për Gratë”, ku gjendet një sallë e madhe dhe është shumë adekuate për qëndrim ditor të të moshuarve.

Abdullah Klinaku, drejtor i DSHPS-së - paraqiti sqarime shtesë dhe iu përgjigj disa pyetjeve të anëtares së kuvendit F. Hazirit lidhur me informatën në fjalë.

Zoran Rakiç, anëtar i kuvendit - lidhur me çështjen e strehimit, tha se në romët në fshatin Prelluzhë banojnë në kushte të rënda, prandaj propozoi që për vitin e ardhshëm të përmirësohet gjendja e tyre prej ndonjë donacioni, sepse ata nuk kanë prona të tyre, por do të ishte mirë që të strehohen në ndonjë ndërtesë kolektive.

3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit - duke iu referuar informatës në fjalë, tha se krijohet përshtypja se në komunën tonë është punësuar një numër i madh i punëtorëve dhe qytetarëve tonë, por kur analizohet numri i madh i bizneseve, dhe faktin e numrit prej 4168 të të punësuarve në bizneset individuale dhe të vetëpunësuar nënkuptohet se një numër i madh i punëtorëve kanë mbetur pa punë, prandaj pyeti se komuna a disponon me këto të dhëna dhe cili është numri i të papunëve nga bizneset e shuara.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - paraqiti sqarime lidhur me diskutimin e A. Bregajt, si dhe lidhur me informatën në fjalë.

4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e ambientit.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit - tha se informata në fjalë është e mangët, pasi që në të është dashtë të përfshihet edhe pastërtia nëpër institucione shtetërore dhe private. Pastaj tha se djegia e mbeturinave, hedhja e tyre nëpër vende të ndryshme e ndot ambientin, prandaj pyeti se sa janë marrë masa? Po ashtu në informatën në fjalë është dashtë të përmenden: sa po shkatërrohen pyjet në komunën tonë; kush e mirëmban sheshin e qytetit. Në fund tha se qentë endacakë janë ndër faktorët që ndikojnë në ndotjen e ambientit, prandaj është mirë të informohemi se çka është ndërmarrë për eliminimin e tyre.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - tha se jo vetëm Vushtrria, por e gjithë Kosova ka problem lidhur me menaxhimin e ambientit, duke shtuar se Komuna e Vushtrrisë ka kontraktuar kompaninë "Uniteti" për pastrimin e rrugëve, por fatkeqësisht njësia e kësaj kompanie në Vushtrri menaxhohet shumë keq, por komuna është duke punuar shumë për një ambient sa më të pastër.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - ngriti shqetësimin e tij për lagjen ku banon (lagjen të "Kosova Petrol"), pasi që edhe përkundër pagesës së taksës për grumbullimin e mbeturinave, në këtë lagje është formuar një grumbull i madh i mbeturinave dhe djegia e tyre eventuale paraqet rrezik edhe për trafostacionin i cili gjendet afër tyre, prandaj është e nevojshme që inspekcioni ta inspektojë atë vend por edhe vendet tjera ku hedhen mbeturinat.

5. Shqyrtimi i Propozimit për konfirmim të investimeve kapitale me bashkëfinancim për vitet 2015 dhe 2016.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - duke iu referuar propozimit për investime kapitale, tha se qysh më herët jemi dakorduar që neve të na vijnë investime nga shtetet tjera, të investohet në rrjetin e ujësjellësit në pjesën e Artakollit, edhe pse zotimet kanë qenë që të kryhet në këtë vit, kurse në këtë vit nuk është planifikuar asgjë.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - kërkoi që hartuesi i propozimit në fjalë të paraqet para anëtarëve të kuvendit sqarime shtesë lidhur me propozimin për konfirmim të investimeve kapitale.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - lidhur me propozimin në fjalë, pyeti se pse nuk është përfshirë edhe fshati Pasomë, pasi që gjendja e ujit është shumë e rëndë në fshatin Pasomë, duke shtuar se ky fshat është shumë afër me fshatin Smrekonicë. Në fund paraqiti shqetësimin e qytetarëve pasi që në lagjen "Qazim Ferati" është dëmtuar një gyp i ujit, prandaj kërkoi që të sanohet, sepse ka dy muaj që ka derdhje të ujit nga ai gyp.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se një projekt i tillë është me rëndësi dhe peshë të veçantë për qytetin dhe qytetarët e Vushtrrisë, duke shtuar se është e nevojshme që realizimi i projekteve të jetë gjithëpërfshirës për territorin e komunës sonë. Po ashtu tha se

gjërat duhet të jenë të konkretizuara, pasi që edhe komuna po hyn në obligime, prandaj të ceken afatet prekluzive të realizimit të këtyre projekteve.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - paraqiti sqarime shtesë lidhur me diskutimet e anëtarëve të kuvendit sa i përket propozimit për konfirmim të investimeve kapitale me bashkëfinancim për vitet 2015 dhe 2016.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim konfirmohet gatishmëria e Komunës së Vushtrrisë për bashkëfinancim të projektit KSV/018 në vlerë prej shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë euro (760.000 €) për ndërtim të rrjetit të ujësjellësit si në vijim:

ndërrimi i gypave të ujësjellësit në rr. “Bedri Pejani, Vesli Klark, Mehmet Konjuhi, Lidhja e Lezhës, Zahir Pajaziti, Nexhip Dragaj dhe Shemsi Istrefi”;
montimi i treqind (300) ujëmatësve në ekonomitë familjare;
instalimi i gypit të ri Smrekonicë – Vushtri;
ndërrimi i gypit në hyrje të qytetit;
instalimi i ujëmatësit në hyrje të rezervuarit në Vushtri;
instalimi i ujëmatësve në disa zona të qytetit;
riparimi i pajisjeve elektrike në rezervuarin e ujit në Vushtri.

Projekti në fjalë duhet të realizohet në dy faza: në fazën e parë (viti 2015) LUX DEVOLOPMNET do të investojë në vlerën prej treqind e pesë mijë euro (305.000 €), ndërsa në fazën e dytë (vitet 2015-2016) do të shfrytëzohen mjetet tjera në shumën prej njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë euro (155.000 €) të LUX DEVOLOPMNET, si dhe mjetet e komunës në vlerë prej treqind mijë euro (300.000 €), të cilat duhet të sigurohen si vijon:

shuma prej tridhjetë mijë euro (30.000 € - nga fondi për bashkëfinancim) deri në muajin prill 2015;
shuma prej dyqind e shtatëdhjetë mijë euro (270.000 €) duhet të sigurohet me buxhetin e vitit 2016, deri në muajin prill 2016.

Autorizohet Kryetari i Komunës që të nënshkruajë marrëveshjen e bashkëpunimit me LUX DEVOLOPMENT për realizimin e projektit në fjalë.

6. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - përkrahu propozim-vendimin në fjalë, duke apeluar që i njëjti të aprovohet, pasi që ky propozim është në favor të qytetit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit - kërkoi që propozim-vendimi në fjalë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme të kuvendit, pasi që ky propozim-vendim nuk ka informacione (arsyetime) të mjaftueshme për t'u aprovuar në këtë mbledhje të kuvendit.

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - përkrahu propozimin e I.Hajrizit, duke shtuar se shumë herë janë keqpërdorur donacionet, por është e nevojshme që të ketë informacione shtesë lidhur me personin i cili ka bërë kërkesën, si dhe lidhur me projektin në fjalë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - paraqiti sqarime shtesë lidhur me propozim-vendimin në fjalë, duke shtuar se ky propozim-vendim shkon në favor të fermerëve të Komunës së Vushtrrisë, dhe sqaroi se prona në fjalë është pronë private, dhe e njëjta nuk

është pronë komunale, dhe një pjesë e asaj toke është tokë bujqësore, dhe për të ka kërkuar të shndërrohet në tokë ndërtimore, prandaj apeloj që të mos pengohen bizneset.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 29 vota “për”, 5 “kundër” vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim lejohet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore, e cila është e evidentuar në Certifikatën parcela kadastrale P-70202022-00622-3 me kulturë “arë” e klasës së pestë (5-të) në sipërfaqe prej 2979 m² Zona Kadastrale Gracë, pronë e Burim (Azem) Selmani me vendbanim në Mitrovicë.

Në parcelën kadastrale të cekur si në nenin 1 të këtij Vendimi lejohet ndërtimi i objektit (depo frigorifer), i cili do të shërben për ushtrimin e veprimtarisë për grumbullimin e pemëve dhe perimeve.

7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për formimin e komisionit për çështje banesore.

Abdullah Klinaku, drejtor i DSHPS-së - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë, kurse të propozuarit nga kryetari i komunës për këtë komision janë: Naim Ferizi dhe Behram Rrahmani, ndërsa nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale propozohet Ramiz Bunjaku.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit - pyeti pse AAK-ja nuk është e përfshirë në këtë komision, kur dihet se ky subjekt ka dalë i treti për nga fuqia e votës në zgjedhjet e fundit lokale.

Abdullah Klinaku, drejtor i DSHPS-së - sqaroi se përbërja e komisionit është në përputhje të plotë me rregulloren komunale, e cila përcakton përbërjen sipas numrit të ulëseve në kuvendin e komunës.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - pyeti se sa banesa janë në pronësi të komunës dhe ku gjenden ato?

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - tha se çdo akt i kuvendit të komunës i nënshtrohet vlerësimit të ligjshmërisë në MAPL, prandaj edhe në këtë rast nëse ka mosrespektim të ligjshmërisë, ministria kompetente do të rekomandojë për rishqyrtim në kuvendin e komunës.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit - në emër të Grupit kuvendar të PDK-së për anëtar të komisionit propozoi Safet Osmanin.

Agron Perquku, anëtar i kuvendit - në emër të Grupit kuvendar të LDK-së për anëtare të komisionit propozoi Fatime Hazirin.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - në emër të Grupit kuvendar të LVV-së për anëtar të komisionit propozoi Mehmet Selacin.

Fakete Dushi, anëtare e kuvendit - nga PD-ja për anëtar të komisionit propozoi Ermal Lahun.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 32 vota “për”, 1 “kundër” vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim formohet komisioni për çështje banesore për banesat në pronësi të komunës sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, në këtë përbërje:

Safet Osmani, anëtar i kuvendit (PDK);

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit (LDK);

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit (LVV);

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit (PD);

Naim Ferizi, zyrtar i komunës;

*Behram Rrahmani, zyrtar i komunës;
Ramiz Bunjaku, zyrtar i QPS-së.*

8. Të ndryshme:

a. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndarje të mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione;

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me propozimin-vendimin në fjalë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim lejohen mjete financiare në shumën prej një mijë euro (1000 €) nga buxheti i komunës (subvencione dhe transfere – Fondi për Emergjencë i Zyrës së Kryetarit të Komunës) për mbulim të shpenzimeve për material ndërtimor për ndërtimin e kulmit të shtëpisë për familjen e znj. Fatbardha Shabani nga fshati Pantinë.

b. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për formimin e komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale;

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit - në emër të Grupit kuvendar të PDK-së për anëtare të komisionit propozoi Xhevahire Selmanin.

Selvetë Sholla, anëtare e kuvendit - në emër të Grupit kuvendar të LDK-së për anëtar të komisionit propozoi Agron Perqukun.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - në emër të Grupit kuvendar të LVV-së për anëtare të komisionit propozoi Myrvete Hetemin.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - nga ekzekutivi i komunës për anëtarë të komisionit propozoi Iliriana Nurën dhe Bajram Beqirin.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim formohet Komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 01Nr.330/12, dt.27.12.2012 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale në këtë përbërje:

Xhevahire Selmani, anëtare e kuvendit (PDK);

Agron Perquku, anëtar i kuvendit (LDK);

Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit (LVV);

Iliriana Nura, zyrtare e komunës;

Bajram Beqiri, zyrtar i komunës.

c. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - të gjithë qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë ua uroi festën e 28 Nëntorit.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - paraqiti vërejtje për informatën që ka marrë nga Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, me arsyetimin se nuk ka kërkuar të informohet rreth përbërjes së komisionit, por ka kërkuar listën e të intervistuarve dhe të të pranuarve, prandaj kërkoi përsëri nga Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural që brenda një afati të shpejt t'ia dërgoi listën e të intervistuarve dhe të të pranuarve për regjistrimin e bujqësisë.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - përsëri paraqiti shqetësimin e qytetarëve, pasi që nga reshjet e fundit është prishur rruga Gllavotin-Beçuk, e cila në çdo moment paraqet rrezik potencial për humbjen e jetës së ndonjë qytetari, kështu që kërkoi që të ndërmerren masa urgjente për rregullimin e rrugës në fjalë, duke shtuar se kryetari ka vepruar në këtë drejtim, por ka pasur rënie të shiut dhe gjendja e rrugës në fjalë është përkeqësuar edhe më shumë, prandaj kërkoi informatë me shkrim pse nuk po intervenohet në rregullimin e rrugës. Pastaj paraqiti shqetësimin tjetër, pasi që disa familje në fshatin Stroc kanë marrë gypa dhe kanë krijuar një kanalizim, ku uji i atij kanalizimi derdhet në oborrin e xhamisë dhe përpara dyerve të disa shtëpive, prandaj kërkoi që të ndërmerren masa edhe në këtë drejtim.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit - lidhur me informatën e shëndetësisë (nga mbledhja e kaluar e kuvendit) kërkoi nga anëtari i kuvendit të komunës Mehmet Selaci, që për hir të së vërtetës të kërkojë falje publike për shkak të dezinformatës se edhe në ambulancën e fshatit Samadrexhë nuk po respektohet orari i punës, pasi që e vërteta është se orari i punës respektohet në ambulancën e fshatit Samadrexhë. Pastaj ngriti shqetësimin e shitoreve në afërsi dhe në brendësi të oborreve të shkollave, ku ka hasur në artikuj që nuk bën të shiten për fëmijë të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, duke shtuar se artikujt ushqimorë janë edhe pa afat dhe të njëjtit janë të dëmshëm për shëndetin e fëmijëve, prandaj kërkoi që të merren masa nga inspekcioni.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit - ngriti shqetësimin për lagjen e tij, e cila ka mbetur pa ndriçim publik, duke filluar prej punëtorisë së Kollarëve e deri te xhamia. Pastaj tha se në shumicën e rasteve përfituesit e tenderëve po janë nga komunat tjera, prandaj pyeti pasi që i plotësojnë kushtet, pse nuk i jepet tenderi ndonjë kompanie nga Vushtrria, kështu që kërkoi që kur bëhet fjalë për tender t'ju jepet përparësi kompanive nga Vushtrria.

Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit - pasi që ka shqetësime të mëdha nga qytetarët, kërkoi informatë për çështjen e emërtimit të rrugëve.

Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit - paraqiti shqetësimin e shumë qytetarëve të fshatit Ashlan lidhur me emërtimin e rrugëve, duke shtuar se është një lagje në këtë fshat, në të cilën qe 15 vite nuk është investuar asnjëherë në të, edhe pse banorët e kësaj lagje janë pagues të rregullt të tatimit në pronë, dhe gjatë stinës së dimrit kjo lagje bëhet e pakalueshme, prandaj kërkoi që të investohet sa më shpejt në këtë lagje.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit - tha se edhe në mbledhjen e kaluar të kuvendit ka kërkuar sqarim rreth punimeve në rrugën kryesore Prishtinë-Mitrovicë, në të cilën janë duke u zhvilluar punime (tek Auto Fellnet e Cakajve), e cila pronë për tjetër gjë është dhënë, e për tjetër gjë shfrytëzohet, prandaj kërkoi që të verifikohet gjendja përmes një komisioni, pasi që banorët e fshatit Lumadh, për shkak të kësaj prone po detyrohen që të udhëtojnë 2 kilometra më shumë për t'u kthyer në Vushtrri. Në fund kërkoi që të formohet një komision për t'u rishikuar të gjitha lejet e lëshuara pas luftës në atë zonë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - duke iu referuar pyetjeve të anëtarëve të kuvendit, u përgjigj me sa vijon: janë marrë masa konkrete për rregullimin e rrugës Gllavotin-Beçuk, por përsëri do të punohet në këtë drejtim; shqetësuese është ngritja e disa kiosqeve në anën tjetër të rrugës, të cilat paraqesin rrezik për kalimin e rrugës nga nxënësit prej shkollës për të shkuar në kiosqe; vendosja e ndriçimit publik realizohet përmes projektit të dedikuar për këtë çështje, dhe aty ku nuk është realizuar deri më tani ndriçimi publik, ka mbetur për vitin e ardhshëm; dhënia e tenderëve bëhet përmes respektimit të ligjit, pasi që ligji i trajton të barabartë të gjithë aplikuesit në tender; shumë ankesa kanë ardhur nga qytetarët lidhur me emërtimin e rrugëve, por kjo çështje ka qenë kompetencë e komisionit, i cili ka vepruar në përputhje të plotë me rregulloren dhe e cila ka shërbyer për punën e tyre, duke shtuar se të gjitha ankesat do t'ia adreson komisionit; në fshatin Ashlan mund të shkohet përmes tri rrugëve të asfaltuara, por është e pamundur që të gjitha lagjet të asfaltohen në të njëjtën kohë, duke shtuar se për disa rrugë të rendit të IV-të duhet të mendohet për t'ua shtruar në zhavorr;

projekti i ndërtimit të rrugës Prishtinë-Mitrovicë nuk është projekt i komunës, dhe çdo shqetësim të qytetarëve për këtë rrugë ua dërgojmë në Ministrinë e Infrastrukturës.


Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit - tha se qytetarët e fshatit Gumnishtë kërkojnë të informohen nga komisioni për emërtimin e rrugëve pse asnjë rrugë nuk e ka emrin e Rrustem Hysenit.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se është e nevojshme që të kontrollohet kualiteti i ndërtimit të rrugëve brenda afatit ligjor nga organet mbikëqyrëse (me theks të veçantë përmendi rrugën “Gjergj Kastrioti - Skënderbeu”), pasi që shumë rrugë po fillojnë të dëmtohen dhe shkatërrohen menjëherë pas ndërtimit të tyre.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - sqaroi se ekziston komisioni për mbikëqyrjen e ndërtimit të rrugëve dhe se nuk mund të bëhet pranimi teknik pa u sanuar defektet eventuale, kurse lidhur me rrugën në fjalë sqaroi se akoma nuk është bërë pranimi teknik i saj.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55.

Albanez Tahiraj



Procesmbajtës

Shpëtim Zhegrova



Kryesuesi i Kuvendit